



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 680 Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM

Nr. 258, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion objekt ekzistues + shtesë kati”, brenda kufirit Qendër Historike Shkodër, me Nr. Pasurie 5/440, Zona Kadastrale 8593, me aplikues Zef Çuni dhe zhvillues **Senad Nikshiqi** dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
 - Të paraqitet autorizimi i qiramarrësve që autorizon Z. Zef Çuni për të aplikuar në sistemin e-albania për Bonus Rijetëzimi.
 - Të paraqitet deklarata e bashkëqiramarrësit (objekti është marrë më qera për 8 vjet nga z. Senad Nikshiqi dhe Vitor Dema).
 - Në dokumentacionin grafik mungon pozicioni i objektit në lidhje me Qendrën Historike të Shkodrës;
 - Kërkohet plotësim i projektit nga ana grafike si dhe foto të gjendjes ekzistuese faktike;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

